



Udhëzim Administrativ (MFPT)  
Nr. 01/2025 për shfrytëzimin e  
pajisjeve elektronike fiskale, sistemeve  
fiskale dhe softuerëve elektronikë fiskal

Më 15 prill 2025, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) miratoi Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2025, i cili ka për qëllim rregullimin e shfrytëzimit të pajisjeve elektronike fiskale, sistemeve fiskale dhe softuerëve elektronikë fiskalë në Republikën e Kosovës. Ky udhëzim synon të përmirësojë administrimin e procedurave tatimore, duke siguruar një sistem më transparent dhe efikas të fiskalizimit në përputhje me zhvillimet e fundit teknologjike. Përmes tij, synohet harmonizimi i procedurave me standardet bashkëkohore dhe përmirësimi i bashkëpunimit midis ATK-së dhe tatimpaguesve, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillimin ekonomik.

Pikat kryesore të këtij Udhëzimi Administrativ janë përmbledhur si në vijim:

Si fillim, udhëzimi përcakton se detyrim për lëshim të kuponëve fiskal është për të gjithë ata që furnizojnë mallra dhe/ose shërbime me konsumatorin e fundit dhe furnizimet falas të mallrave dhe/ose shërbimeve për konsumatorin e fundit pavarësisht formës së pagesës. Ndërsa përjashtim nga ky obligim janë, për furnizimet ndaj personave fizikë afaristë, personave juridikë, dhe subjekteve të tjera ku përdoret fatura tatimore.

Sipas këtij udhëzimi kuponi duhet të lëshohet në momentin e pagesës së mallrave dhe/ose shërbimeve, ose nëse furnizimi ndodh para pagesës, atëherë kuponi fiskal duhet të lëshohet në momentin e furnizimit.

Përmes këtij udhëzimi është paraparë Softueri Elektronik Fiskal (SEF), është softuer elektronik i zhvilluar për të regjistruar dhe raportuar transaksionet financiare të tatimpaguesve në mënyrë të automatizuar dhe në përputhje me legjislacionin tatimor në Republikën e Kosovës dhe tatimpaguesit që operojnë në shitje me pakicë, ofrojnë shërbime në vende publike, ose kryejnë aktivitete të ngjashme, duke përfshirë edhe ndërmarrjet publike dhe shoqërore janë të obliguar të bëjnë instalimin e këtij softueri. Ndërsa kategoritë e përjashtuara nga instalimi i SEF janë, institucionet publike që pranojnë vetëm pagesa elektronike, dhe bizneset që furnizojnë vetëm subjekte të tjera biznesi, B2B.

Për më shumë në udhëzim trajtohen edhe shitjet përmes pajisjeve të vetëshërbimit (automatë), duke i konsideruar ato si pajisje elektronike për shitje cash, ku nuk ka pjesëmarrje të shitësit, të cilët po ashtu janë të obliguar të instalojnë SEF.

Blerësit dhe të gjithë marrësit e kuponëve fiskal, mund të verifikojnë nëse kuponi fiskal është raportuar në ATK. Procesi i verifikimit bëhet duke skanuar Kodin QR në kuponin fiskal, përmes aplikacionit të veçantë nga një telefon inteligjent, apo nga ndonjë pajisje tjetër elektronike që ka funksionin e skanimit.



Po ashtu me këtë udhëzim parashihen edhe kuponët fiskal korrigjues të cilët duhet të përmbajnë referencë të kuponit origjinal. Për më shumë udhëzimi parasheh që në rast të ndërprerjes së internetit, tatimpaguesi duhet të lëshojë kuponë fiskalë të cilët duhet të dorëzohen në ATK brenda 48 orëve, ndërsa në rast të ndërprerjes së plotë të pajisjes, përdoren kuponë nga një bllok i veçantë, të cilët duhet të regjistrohen në ATK brenda 5 ditëve.

Në rast të se moszbatimit të rregullave të fiskalizimit dhe lëshimit të kuponit fiskal, si dhe mosfunksionimi i PEF/SF dhe SEF-ve, tatimpaguesi është subjekt i sanksioneve me gjopa të rënda sipas Ligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore.

Udhëzimi përfshinë edhe dipozitën e tranzicionit që nënkupton se me qëllim që të lehtësohet procesi, Ministri i Financave do të caktojë tatimpaguesit dhe afatin kohor për kalimin nga PEF/SF në SEF.

Sipas këtij udhëzimi tatimpaguesit që nuk kanë Pajisje Elektronike Fiskale/Sistem Fiskal duhet të fillojnë përdorimin e SEF brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, duke përdorur kuponë tatimorë të fiskalizuar në ATK gjatë kësaj periudhe tranzicionale.

Burimi: [link](#)





# Administrative Instruction (MFPT) No. 01/2025 on the Use of Electronic Fiscal Devices, Fiscal Systems, and Electronic Fiscal Software

On April 15, 2025, the Ministry of Finance, Labor, and Transfers (MFPT) approved Administrative Instruction No. 01/2025, aimed at regulating the use of electronic fiscal devices, fiscal systems, and electronic fiscal software in the Republic of Kosovo. This instruction seeks to improve the administration of tax procedures by ensuring a more transparent and efficient system of fiscalization in accordance with recent technological developments. It aims to harmonize procedures with contemporary standards and enhance cooperation between the Tax Administration of Kosovo (TAK) and taxpayers, creating a more favorable environment for economic development.

The main points of this Administrative Instruction are summarized as follows:

Firstly, the instruction specifies the obligation to issue fiscal coupons for all those who supply goods and/or services to the final consumer, including free supplies of goods and/or services to the final consumer, regardless of the payment form. However, an exception from this obligation applies for supplies to individual businesses, legal entities, and other subjects using tax invoices.

According to this instruction, a coupon must be issued at the time of payment for goods and/or services, or if the supply occurs before payment, then the fiscal coupon must be issued at the time of supply.

The instruction provides for Electronic Fiscal Software (EFS), an electronic software developed to record and report the financial transactions of taxpayers in an automated manner and in compliance with the tax legislation in the Republic of Kosovo. Taxpayers operating in retail sales, offering services in public places, or engaging in similar activities, including public and social enterprises, are obligated to install this software. Exceptions to the installation of EFS include public institutions that only accept electronic payments and businesses that only supply other business entities (B2B).

The instruction also addresses sales through self-service devices (machines), considering them electronic devices for cash sales where there is no seller involvement, which are also required to install EFS.

Buyers and all recipients of fiscal coupons can verify whether the fiscal coupon has been reported to TAK. The verification process is carried out by scanning the QR Code on the fiscal coupon via a special application from a smartphone or other electronic device with scanning functionality.



Moreover, the instruction includes corrective fiscal coupons that must reference the original coupon. Additionally, it stipulates that in the event of internet disruption, the taxpayer must issue fiscal coupons that must be submitted to TAK within 48 hours, whereas in case of complete device failure, coupons from a special block must be used and registered with TAK within 5 days.

Failure to comply with fiscalization rules and the issuance of fiscal coupons, as well as the malfunctioning of PEF/SF and EFS systems, subjects the taxpayer to penalties with severe fines according to the Law on the Administration of Tax Procedures.

The instruction also includes the transition deposit, meaning that, to facilitate the process, the Minister of Finance will designate taxpayers and the timeframe for transitioning from PEF/SF to EFS.

According to this instruction, taxpayers without Electronic Fiscal Devices/Fiscal Systems must start using EFS within 60 days from the entry into force of this instruction, using tax coupons fiscalized with TAK during this transitional period.

Source: [link](#)





## PricewaterhouseCoopers Kosovo

Str. Mujo Ulqinaku No. 5 Apt. 10 Qyteza Pejton

Prishtina, Kosovo

Telephone: +383 38 722 555

Email: [al\\_pwc\\_kosovo@pwc.com](mailto:al_pwc_kosovo@pwc.com)

Web: [www.pwc.com/ks](http://www.pwc.com/ks)

